



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:042361
Datë: 18.10.2018
Numri i dokumentit: 00149647

P.nr.488/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikantin Muhamed Haliti, në lëndën penale kundër të akuzuarve M.M. e A.M. (ndaj të cilës është veçuar procedura penale), për shkak të veprës penale Vjedhja, nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 661/2016, të datës 18.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 17.10.2018, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 18.10.2018, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.M., nga babai E. dhe nëna Z., e lindur H., i lindur më datë ... në Prishtinë, me vendbanim në fshatin ..., K. e ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, punon si kamarier, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, më datë 09.04.2016, rreth orës 21.30 min. në Gjilan, në rr. “Lidhja e Prizrenit”, në marketin “Inerex2, në bashkëkryerje me të akuzuarën A.M. (për të cilën është veçuar procedura penale, për shkak se gjendet jashtë Kosovës), me qëllim të përfitimit të kundërligjeshëm pasuror për vete, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës “Interex”, në atë mënyrë që kanë hyrë bashkë në market dhe e akuzuara A., ka marrë katër krema të kozmetikës të markës “Nivea” dhe i ka futur në çantën e saj dhe me të arritur te arka, kremat nuk i ka deklaruar fare, por, i ka paguar vetëm disa artikuj ushqimor, e duke dalur, është ndalë nga sigurimi, ndërsa, i akuzuari M. gjatë kontrollimit nga pjesëtarit e policisë, në veturën “Opel Corsa”, me tabela 0..., i janë gjetur edeh shtatë krema të markës “Nivea” dhe dy ngjyra të markës “Palete”, me çka, të dëmtuarës i kanë shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar,

-me çka kanë kryer veprën penale, **Vjedhje** nga **neni 325 par. 1** lidhur me **nenin 31 të KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit M.M., me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh** dhe **Dënim Gjoke**, në shumën prej **150 (njëqindpesëdhjetë) €**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti**, nuk kryen veprën tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj **paushallin gjyqësor** në shumë prej **15 (pesëmbëdhjetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzën PP.II.nr. 661/2016, të datës 18.04.2016, kundër të akuzuarve M.M. e A.M. (për të cilën është veçuar procedura), për shkak të veprës penale, Vjedhja, nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtit t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit M.M., erdhi në përfundim se i akuzuari e ka kryer veprën penale Vjedhje, nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar vullnetarisht, pa presion fajësinë, pas njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, pati sjellje të mira në Gjykatë, pendimi i tij, si dhe premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 par. 4 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr. 488/2016, më datë 18.10.2018

Praktikanti,
Muhamet Haliti

Gjykatësja e vetme gjyqësore,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:042361
Datë: 18.10.2018
Numri i dokumentit: 00149647